



BASHKIA TIRANË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ÇERDHEVE DHE KOPSHTEVE

PROGRAMI I EDUKIMIT PËR FËMIJËT 18-24 MUAJSH PËR MUAJIN PRILL




PËR STAFIN EDUKATOR TË ÇERDHEVE PUBLIKE TË TIRANËS

Kuriozitete për muajin PRILL

Çfarë duhet të dimë për muajin Prill?

- * Muaji Prill është muaji i dytë i stinës së pranverës.
- * Prilli është muaji i luleve, i ngjyrës së gjelbërt dhe i poezisë.
- * Muaji Prill shënon Ditën Ndërkombëtare të Zogjve.
- * Muaji Prill është muaji i ndërgjegjësimit për librin.
- * Në muajin Prill është Dita e Balonave.



Muaji Prill-Tema: Qyteti dhe fshati

Grupi: 18-24 muajsh

- * **Java I:** Elementët e qytetit
- * **Java II:** Elementët kryesorë të fshatit
- * **Java III:** Njohja me mjetet e transportit
- * **Java IV:** Respektojmë rregullat në komunitet

Tema mujore: Qyteti dhe fshati


Temat Javore	Qëllimi	Koha e realizimit
Njohja me elementët kryesorë të qytetit	Njohja me elementët kryesorë të qytetit si: lagjet, pallatet, rrugët, parqet.	Java I
Njohja me elementët kryesorë të fshatit	Njohim me disa elementë kryesore të fshatit si: fusha, pylli, ferma, etj.	Java II
Njohja me mjetet e transportit	Njohja me mjetet e transportit.	Java III
Respektojmë rregullat në komunitet	Njohja me rregullat e komunitetit ku banojmë. Njohja me rregullat në çerdhe.	Java IV

Shënim:

- * Stafi edukator duhet ta realizojë sa më qartë shpjegimin dhe realizimin e aktiviteteve me qëllim përvetësimin sa më thjeshtë të njohurive nga fëmijët.
- * Stafi edukator duhet të informojë prindërit mbi tematikën mujore/javore për të siguruar bashkëpunimin e tyre dhe diskutimin me fëmijët në shtëpi.

Tema mujore: Qyteti dhe fshati
Tema e javës: Njohja me qytetin




Java I	Rubrika	Aktivitetet	Mjetet e Punës
E Hënë	Njohim qytetin tonë 	<p>Bisedë edukatore-fëmijë: Edukatorja iu flet fëmijëve për qytetin. Ajo, nëpërmjet fotove, librave, revistave demonstroi pamje nga qyteti: rrugët, parqet, këndet e lojërave, pallatet, shkollat, kopshtet, çerdhet. Edukatorja pyet fëmijët nëse ata shkojnë të luajnë tek këndet e lojërave apo nëse shëtisin në parqe, lulishte, shëtitore. Edukatorja iu tregon fëmijëve se fëmijët shkojnë në park bashkë me prindërit ose të rriturit. Aty luajnë edhe me fëmijë të tjerë.</p> <p>Loja imituese: “Piknik në qytet”. Edukatorja emërton sendet që kanë marrë me vete për piknik. Loja zhvillohet në oborr.</p> <p>Vjersha: “Ora e qytetit”.</p> <p>Kënga: “Hapa dollapa”</p> <p>Loja: “Ngriva shkriva”</p>	Mjete Didaktike: lapsa me ngjyra, fletë të bardha/fletë me ngjyra.
E Martë	Vendet historike në qytetin tonë	<p>Vjersha: “Ora e qytetit”.</p> <p>Bisedë edukatore-fëmijë: Edukatorja iu flet fëmijëve për</p>	Mjete Didaktike: foto, revista, libra.



		<p>vende në qytet ku fëmijët kalojnë kohën e lirë me familjen, gjyshërit, si: Parku i Liqenit, Sheshi “Skënderbej”, këndet e lojërave, etj.</p> <p>Kënga: “Ç’u rrëzova bum ç’u rrëzova”.</p>	Manuali i Vjershave
E Mërkurë	<p>Ora</p> 	<p>Vjersha: “Ora e qytetit”.</p> <p>Aktivitet: Edukatorja vizaton një orë dhe iu shpjegon fëmijëve elementët e saj.</p> <p>Kënga: “Tring zilja”.</p> <p>Punë dore: Krijimi i orës me mjete te riciklueshme(si p.sh një pjatë plastike, tapa shishesh për të vendosur numrat dhe kunjat apo pipa për akrepat)</p>	Manuali i Vjershave Manuali i Lojrave
E Enjte	<p>Njohja me kafshët shtëpiake</p> 	<p>Vjersha: “Shtëpia e bubit”.</p> <p>Bisedë edukatore-fëmijë: Edukatorja flet për kafshët shtëpiake si: macja, qeni (që rriten në apartamente dhe shtëpi). Ajo pyet fëmijët nëse ata kanë kafshë shtëpiake?/Si quhen ato?/A kujdesen për to?</p> <p>Kënga: “Macja le të lahet”.</p> <p>Loja : “Imitimi i kafshëve shtëpiake”</p> <p>Lojë me rathë: Fëmijët kalojnë përmes rathëve. Edukatorja fillimisht i vendos rathët ngjitur dhe më pas fillon i largon aq sa fëmija mund t’i kalojë.</p>	Manuali i Vjershave
E Premte	<p>Krijimi i zogjve me punë dore</p> 	<p>Vjersha: “Qukapiku”.</p> <p>Kënga: “Zogu cicëron”.</p> <p>Lojë energjike: “Këngë lëvizore 1” dhe “Këngë lëvizore 2”.</p> <p>Punë dore: Edukatorja iu demonstroi fëmijëve krijimin e zogjve me punë dore (edukatorët mund të përdorin modelet e këtij materiali) duke përdorur pjatat plastike.</p> <p>Përralla: “Mbreti i fluturimeve”.</p>	Manuali i Vjershave Mjete didaktike: pjata plastike me ngjyra te ndryshme.

Tema e javës: Njohja me fshatin





Java II	Rubrika	Aktivitetet	Mjetet e Punës
<p>E Hënë</p>	<p>Njohja e elementëve kryesorë të fshatit</p> 	<p>Bisedë edukatore-fëmijë: Edukatorja u tregon fëmijëve pamje nga fshati, si livadhet, fushat, fermat, shkollat, shtëpitë./Pyet fëmijët se cilët kanë gjyshër/të afërm në fshat./Iu flet fëmijëve për të mirat e fshatit, për prodhimet buqësore (perimet, frutat) dhe blegtorale (qumështi, gjalpi, djathi, gjiza, etj) duke e ilustruar me produktet që fëmijët konsumojnë në çerdhe.</p> <p>Kënga: “Fshati im”.</p> <p>Vjersha: “Pula pikaloshe”</p> <p>Lojë energjike: “Vigani, shkurtabiqi”.</p>	<p>Manuali i Lojrave Mjete Didaktike: libra, lapsa me ngjyra, karton A3.</p>






<p>E Martë</p>	<p>Njohja me elementët natyrorë të fshatit</p> 	<p>Kënga: “Fshati im”.</p> <p>Bisedë edukatore-fëmijë: Edukatorja iu shpjegon fëmijëve për malin dhe fushën: mali është i lartë dhe i madh; fusha është e sheshtë. Ajo iu demonstroi fëmijëve figura të maleve dhe fushave.</p> <p>Vjersha: “Kafshët në fermë”.</p> <p>Kënga: “Sa do të doja një qenush”.</p> <p>Lojë e lirë: me top.</p>	<p>Mjete Didaktike Manuali i Vjershave</p>
<p>E Mërkurë</p>	<p>Njohja me kafshët që jetojnë në fshat</p> 	<p>Vjersha: “Kafshët në fermë”.</p> <p>Bisedë edukatore-fëmijë: Edukatorja iu flet fëmijëve mbi kafshët e fermave të fshatit (lopa, delja, qengji, keci, dhia, derri, kali, gomari, etj) dhe të mirat që marrim prej tyre, si qumështi, djathi, gjalpi, mishi dhe lëkura, leshi për këpucë dhe veshje.</p> <p>Kënga: “O sa mirë, o sa keq”.</p> <p>Pune krijuese: Ndërtimi i deleve me kokoshka. Përgatitja e qeseve paraprakisht me kokoshka nga edukatorët. Fëmijët ndihmojnë duke ngjitur kokën e deleve me karton dhe duke vendosur sytë.</p>	<p>Manuali i Vjershave Mjete didaktike: karton , qese plastike.</p> 
<p>E Enjte</p>	<p>Njohja me shpendët që jetojnë në fshat</p> 	<p>Kënga: “Pula e vogël e kuqe”.</p> <p>Bisedë edukatore-fëmijë: Edukatorja iu flet fëmijëve mbi shpendët e fshatit (pula, gjeli, rosa) dhe të mirat që marrim prej tyre si, vezët, mishi duke e konkretizuar me produktet që fëmijët konsumojnë si ushqim në çerdhe.</p> <p>Lojë energjike: “Këngë lëvizore 1” dhe “Këngë lëvizore 2”.</p> <p>Vjersha: “Rosat në liqen”.</p> <p>Ngjyrosje: Ngjyrosja e figurave të përgatitura më parë nga edukatorët si: një zog pule, gjeli, etj. (Edukatorët mund të përdorin modelet e këtij materiali).</p>	<p>Manuali i Vjershave Mjete Didaktike</p> 





<p>E Premte</p>	<p>Krijimi i kafshëve me punë dore</p> 	<p>Vjersha: “Kafshët në fermë”.</p> <p>Loja: Imitimi i tingujve të kafshëve që rriten në fermë.</p> <p>Punë dore: Krijimi i kafshëve si lopa, delja, derrkuci, pula (edukatorët të përdorin modelet e këtij materiali që të krijojnë me letra kartoni/pjata plastike kafshë të ndryshme). Edukatorja ndihmon fëmijët të ngjisin sytë, hundën, gojën, veshët e kafshëve dhe ndihmon fëmijët t’i emërtojnë ato.</p> <p>Kënga: “Bubrrrec”. Kënga shoqërohet me lëvizje të trupit. Udhëheq edukatorja.</p> <p>Lojë energjike: “Vigani, shkurtabiqi”.</p>	<p>Manuali i Vjershave</p> <p>Mjetet didaktike: lapsa me ngjyra, pjata plastike, fletë kartoni.</p> 
------------------------	--	---	---

Tema mujore: Qyteti dhe fshati
Tema e javës: Mjetet e transportit



Java III	Rubrika	Aktivitetet	Mjetet e Punës
<p>E Hënë</p>	<p>Njohja me mjetet e transportit</p>	<p>Bisedë edukatore-fëmijë: Edukatorja iu shpjegon fëmijëve se njerëzit shpikën mjetet e transportit, për të udhëtuar, për të çuar mjete dhe sende nga një vend në tjetrin, për të komunikuar (posta çon letra me makinën e saj), për të ndihmuar njerëzit (makina e urgjencës), etj. Mjetet e transportit janë disa llojesh duke filluar nga karroca me kuaj deri tek raketat: biçikleta, motori, makina, autobusi, kamioni, treni, aeroplani, anija.</p>	<p>Manuali i Vjershave</p> <p>Manuali i Lojrave</p> <p>Mjete Didaktike</p> <p>Modele për ngjyrosje:</p> 

		<p>Edukatorja pyet fëmijët: keni udhëtuar me makinë, me autobus? Edukatorja iu përmend profesionet e shoferit, makinistit të trenit, pilotit, timonierit të anijes.</p> <p>Vjersha: “Biçikleta”.</p> <p>Loja imituese: “Si pilot ose si kapiten anije”.</p> <p>Krijim: Edukatorët krijojnë një pazëll me katër pjesë (makinë) dhe më pas ndihmojnë fëmijët t’i bashkojnë ato.</p>	
E Martë	Njohja e mjeteve të transportit nëpërmjet lojës	<p>Kënga: “Autobusi”.</p> <p>Lojë energjike: me top. Loja zhvillohen në oborr.</p> <p>Bisedë edukatore-fëmijë: Edukatorja demonstroi mjetet e transportit që na ndihmojnë në situata rreziku: zjarrfikëse, ambulancë, makinat e policisë, që janë të shpejta dhe të pajisura me mjete shpëtimi.</p> <p>Loja: Imitimi i tingujve të mjeteve të transportit.</p> <p>Krijim: Ngjitja e figurave për të krijuar një park automjetesh (shoqëruar me numërimin e tyre deri në tre).</p>	<p>Mjete Didaktike Modele për ngjyrosje:</p> 
E Mërkurë	<p>Mjetet e transportit Tokësor</p> 	<p>Vjersha: “Treni”.</p> <p>Lojë energjike: “Të gjithë në tren”. Loja zhvillohet në oborr.</p> <p>Bisedë edukatore-fëmijë: Edukatorja iu shpjegon/tregon fëmijëve se mjetet e transportit tokësor janë mjetet që ecin në tokë si: makina, autobusi, treni, bicikleta, karroca, etj.</p> <p>Aktivitetet edukues: “Rregullat e sigurisë kur udhëtojmë” Edukatorja u shpjegon fëmijëve se kur jemi në makinë është e rëndësishme të jemi të ulur tek stoli për fëmijë dhe të jemi gjithmonë të lidhur me rripin e sigurimit. Kur i japim biçikletës duhet të vëmë kokoren.</p> <p>Pune krijuese: Edukatorët ndajnë në gjysmë një pjatë plastike e ngjyrosin dhe fëmijët ngjisin rrotat dhe dritaret, të prera më parë nga edukatorët (modeli ne foto).</p> <p>Kënga: “Autobusi”.</p>	<p>Manuali i Vjershave Manuali i Lojrave</p> 
E Enjte	Mjetet e transportit	Bisedë edukatore-fëmijë. Edukatorja iu shpjegon/tregon	Manuali i Vjershave

	<p>ajror dhe ujqor</p> <p>Krijojmë një balonë</p> 	<p>fëmijëve për mjetet e transportit ajror si: aeroplani, helikopteri, balona, parashuta dhe raketat. Fëmijët emërtojnë mjetet e transportit së bashku me edukatoren.</p> <p>Punë dore: Ndërtimi i një balone. Edukatorja ndihmon fëmijët të ngrenë balonën në oborr.</p> <p>Bisedë: Edukatorja përmend mjetet e transportit ujor: varka, anija, dhe fton fëmijët t'i emërtojnë këto mjete.</p> <p>Vjersha: "Si marinar".</p>	<p>Modele:</p> 
Premte		<p>Vjersha: "Treni".</p> <p>Lojë energjike: me shami, me top. Lojërat zhvillohen në oborr.</p> <p>Punë dore: "Aeroplani me shishe plastike"</p> <p>Kënga: "Autobusi".</p> <p>Punë dore: "Varka". Edukatorja së bashku me fëmijët përgatisin një varkë prej letre.</p>	<p>Manuali i Vjershave</p> <p>Manuali i lojrave</p> <p>Mjete Didaktike:</p> <p>letra pundore, shishe uji.</p>
Tema mujore: Qyteti dhe fshati			
Tema e javës: Respektojmë rregullat në komunitetin			
			
Java IV	Rubrika	Aktivitetet	Mjetet e Punës
E Hënë	Rregullat e sjelljes ne çerdhe	<p>Bisedë edukatore-fëmijë: Edukatorja iu shpjegon fëmijëve rëndësinë e rregullave kur qëndrojnë së bashku në çerdhe. Disa nga rregullat që fëmijët duhet të dinë janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> -Të luajmë së bashku dhe të ndajmë lodrat me njëri-tjetrin. -Të mos shtyjmë/lëndojmë/godasim shokun/shoqen. -Të hamë të gjithë bashkë dhe të zbatojmë rregullat e të ngrënit. 	<p>Manuali i Vjershave</p> <p>Manuali i Lojrave</p> <p>Mjete Didaktike</p>

		<p>-Të mbajmë pastër veten (të lajmë duart, të lajmë dhëmbët). -Të mbajmë pastër ambientin e dhomës/të çerdhes (të mos hedhim mbeturina në tokë, të mos derdhim ushqimin).</p> <p>Aktivitet në natyrë: Fëmijët dalin në oborr dhe bashkë me edukatoren mbledhin mbeturinat, gjethet e pemëve, gurët dhe i hedhin në koshin e plehrave/mbeturinave.</p> <p>Lojë e lirë energjike: me top.</p> <p>Vjersha: “Mirëmëngjes”.</p>	
<p>E Martë</p>	<p>Ecim në vijat e bardha. Semafori</p> 	<p>Vjersha: “Mirëmëngjes”.</p> <p>Bisedë: Edukatorja flet për vijat e bardha dhe rregullat e qarkullimit.</p> <p>Kënga: “Prit sinjalin pastaj ik”</p> <p>Krijim: Krijimi i semaforit, vendosja e vijave të bardha (nëpërmjet fletëve të formatit, karton i bardhë).</p> <p>Aktivitet: Improvizimi i një situatë në semafor (edukatorja ndihmon fëmijët të kalojnë semaforin).</p> <p>Përralla: “Gishtëza”.</p>	<p>Mjete Didaktike Manuali i Vjershave</p> 
<p>E Mërkurë</p>	<p>Të duam, të respektojmë natyrën</p> 	<p>Vjersha: “Mos e këput lulen”.</p> <p>Bisedë edukatore-fëmijë: Edukatorja iu shpjegon fëmijëve se duhet ta duam dhe të kujdesemi për natyrën. Ajo iu kujton fëmijëve se lulet nuk këputen, mbeturinat nuk i hedhim në det/liqen/lumë. Lulet, pemët zbukurojnë ambientin dhe pastrojnë ajrin. Edukatorja pyet fëmijët: Kush ka lule në shtëpi? Kush kujdeset për to?</p> <p>Aktivitet në natyrë: Edukatorja së bashku me fëmijët ujin një lule në oborrin e çerdhes.</p> <p>Vjersha: “Mirëmëngjes”.</p> <p>Lojë e lirë: me kuba, lodra, kukulla.</p>	<p>Manuali i Vjershave Mjete didaktike: gota ose enë vaditëse, ujë.</p> 
<p>E Enjte</p>	<p>Fjalët magjike</p>	<p>Vjersha: “Mirëmëngjes”.</p> <p>Lojë e lirë energjike: me shami. Loja zhvillohen në oborr.</p>	<p>Manuali i Vjershave Manuali i lojrave.</p>

		<p>Bisedë edukatore-fëmijë. Edukatorja iu shpjegon fëmijëve për fjalët magjike dhe rëndësinë e tyre në ambientin ku ne jetojmë. Ajo pyet fëmijët se cili/cila prej tyre mund të thotë një fjalë magjike.</p> <p>Aktivitet: Inskenimi i situatave të ndryshme kur themi “Mirëmëngjes” “Faleminderit”, “Të lutem”, “Më fal”, etj.</p> <p>Kënga: “Fjalët magjike”.</p>	<p>Mjete Didaktike</p>
<p>E Premte</p>	<p>Krijimi i luleve</p>	<p>Kënga: “Fjalët magjike”.</p> <p>Lojë e lirë energjike: me lëvizje ritmike të udhëhequra nga edukatorja. Lojërat zhvillohen në oborr.</p> <p>Vjersha: “Mos e këput lulen”.</p> <p>Punë dore: “Krijimi i luleve të ndryshme me letër, ngjyra, lugë dhe gota plastike, plastelinë (emërtimi i ngjyrave dhe numërimi i tyre)”. Edukatorja ndihmon fëmijët të ngjisin lulet dhe të emërtojnë ngjyrat.</p>	<p>Manuali i Vjershave Mjete Didaktike: lapsa me ngjyra, letër A4, plastelinë.</p>